

03.12.2021  
Ora 11:15

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2. Staf i KQZ:                                      **Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**


**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:

projektvendimi “Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;

pika e dytë është projektvendimi “Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;

pikat e tjera të rendit të ditës kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në Këshillin Bashkiak Kurbin, Mirditë, Himarë, Tiranë, Lezhë, Lushnje, Divjakë dhe Fushë-Arrëz;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

pika e fundit ka të bëjë me projektvendimin "Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Daniel Gjini Prroj, kandidat për deputet i propozuar nga koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor-Emigracioni-Ora e Shpresës dhe Konservatorët", pra Koalicioni ABEOK.

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin "Për miratimin e gjetjeve kyçe të procesit të këqyrjes dhe verifikimit të të dhënave të përfituara nga procesi i identifikimit elektronik, nga pajisjet e përdorura në procesin e identifikimit elektronik në zgjedhjet e 25 prillit". Shkurt me relacionin.

**Z. Y. Merkaj:** Në mbështetje të nenit 14, 19, 23 dhe 167/2 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve janë kompetentë për mbikëqyrjen e procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit, të cilat u aplikuan gjatë zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Procesi i verifikimit paszgjedhor të kryqëzimit të të dhënave ka për qëllim të përcaktojë efektshmërinë e teknologjisë së përdorur dhe rrjedhimisht të ndihmojë KQZ-në në vendimmarrjen e saj për përdorimin në vijim të kësaj teknologjie. Procedura e verifikimit u realizua nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bazuar në udhëzimin nr.15, datë 07.10.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, çdo pajisje e identifikimit elektronik u kthye në magazinën qendrore të KQZ-së, për procesim. Memoret e USB-së u tërhoqën nga pajisjet e identifikimit dhe u qendërzuan në serverin *save*, që është sistemi elektronik i identifikimit të votuesve duke populluar *database*-in e sistemit qendror të identifikimit të votuesve, në nivele të tjera sipas shpërndarjes gjeografike. Pas procesit të kosto-verifikimit të të dhënave të sistemit të automatizuar të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

identifikimit biometrik filloi procesimi i të dhënave duke kryqëzuar çdo identitet kundrejt 1.602.741 votuesve të identifikuar gjatë ditës së zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Pas procesimit nga sistemi i automatizuar i identifikimit biometrik prodhoi rastet e cilësuar nga sistemi si të dyshimta, nga të cilat 1006 u konfirmuan nga stafi i trajnuar i KQZ-së, prej kompanisë kontraktuese si të qenësishme. Gjatë procesit të kryqëzimit u konstatuan se 20 individë me identitet të njëjtë janë identifikuar nga pajisja elektronike e identifikimit PEI në dy qendra votimi të ndryshme, për të cilët do të referohet dhe kallëzimi penal në prokurori. Në përfundim të procesit të kryqëzimit, duke u marrë në konsideratë gjetjet minimale të rasteve të dyshimta nga procesi i kryqëzimit, sugjeroimë implementimin e sistemit të identifikimit elektronik në një shkallë më të gjerë në sistemet e ardhshme të votimit. Referuar udhëzimit nr.15, datë 17.10.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri do të miratojnë raportet e propozuara nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, raportin përkatës, si dhe listën me emrat e personave, të cilët do të kallëzohen penalisht, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Në rregull, faleminderit! Atëherë për rastin kur ne kemi identifikuar shenja gishti, të cilat dyshohet që janë të të njëjtit person, por që gjenden në dy qendra të ndryshme votimi, kemi vendosur që t'i prezantojmë organit të prokurorisë një material kallëzues për të verifikuar në lidhje me këtë fakt. Ky është rasti apo jo? Në rregull! Mirë atëherë, në mbështetje të neneve 14, 19, pika 1 dhe shkronjat "e" dhe "n" si dhe pika 2 dhe 23, dhe pika 8, si dhe neni 167, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë së bashku me Nënkomisioneren, pasi është një akt, i cili ligji obligon Komisionerin dhe Nënkomisioneren për të vendosur në lidhje me këtë çështje,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik sipas dosjes elektronike të inkriptuar që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të bëhet kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 469**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

03.12.2021  
Ora 11:18

**RENDI I DITËS**

Projektvendim "Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021".

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**


2. Stafi KQZ:    **Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me gjetjet kyçe të procesit të verifikimit paszgjedhor, të fletëve të votimit dhe të pajisjes së votimit dhe numërimit elektronik.

**Z. Y. Merkaj:** Në mbështetje të nenit 19, 23 dhe 167/2 të Kodit Zgjedhor Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për mbikëqyrjen e procesit të këqyrjes së mëpasme të fletëve të votimit, materialeve zgjedhore dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të votave. Procesi i këqyrjes së mëpasme ka për qëllim verifikimin e rregullueshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit zgjedhor dhe vlerësimit të numërimit të votave. Gjithashtu pas procesit zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe pas konstituimit të organeve të zgjedhura,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi pajisjet e votimit dhe numërimin elektronik të votave, të përdorura në zgjedhjet e datës 25 prill 2021, të cilat u përdorën në KZAZ nr.40, në Tiranë, për të gjitha qendrat e votimit të kësaj KZAZ-e. Procedura e këqyrjes dhe e verifikimit u realizua në seanca publike dhe me pjesëmarrjen e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të interesuara. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bazuar në udhëzimin nr.15, datë 07.10.2021, nga data 14.10.2021 - 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore. Në datën 14 tetor 2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përzgjedhi në mënyrë rastësore 519 qendra votimi që përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit të çdo KZAZ-je në rang vendi, nga 5199 qendra votimi. Nga kjo listë nuk u përfshinë në përzgjedhje rastësore, qendrat e votimit të sekuestruara nga prokuroria, qendrat e votimit të këqyrura nga KAS-i gjatë procesit ankimor, si dhe qendrat e votimit të KZAZ-së nr.40, të cilat iu nënshtruan procesit të verifikimit të saktësisë të sistemit të votimit dhe të numërimit elektronik. Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 519 qendra votimi, u ngritën 8 grupe numërimi për këqyrjen, të cilat vlerësuan dhe administruan procesverbalet përkatëse për ministrimin dhe informacionin. Për KZAZ nr.40, procesi i verifikimit u shtri në të gjitha qendrat e votimit të kësaj zone të administrimit zgjedhor. Ky proces përfundoi në datën 02.11.2021, i cili vijoi dhe më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e raporteve përmblledhëse mbi respektimin e kërkesave të qendrave të votimit, të kërkesave proceduriale gjatë procesit të votimit, të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit, të votave gjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, si dhe për saktësinë e të dhënave të gjeneruara në mënyrë elektronike nga sistemi PEVN me rezultatin nga numërimi i fletëve të votimit të gjetura në kutitë e votimit. Rregullshmëria e administrimit zgjedhor nga komisioni i qendrës së votimit. Në përgjithësi nga QV e

*Zbardhi materialin audio*


*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

kryqëzuara rezulton se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivel mesatar 79% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore, dhe duke vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor të akteve ligjore, të dala në zbatim të tij. Nga tërësia treguese të performancës të KQV-ve për këtë kategori vendimmarrjeje, komisionet në qendrat e votimit kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në nivel mesatar 86% të tyre. U konstatuan se në 11 komisione të qendrave të votimit nuk kanë plotësuar librin e procesverbalit të mbledhjeve, veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së. Niveli i përputhshmërisë jo domosdoshmërisht përputhet me numrin e komisioneve të qendrave të votimit. Këta të fundit kanë kryer procedurat e marrjes së vendimeve dhe plotësimin në procesverbale të administruara të qendrës së votimit dhe librin e protokollit të mbledhjeve, sipas përcaktimit të nenit 36 e vazhdim të Kodit Zgjedhor. Në mesatarisht 93 qendra votimi baza materiale është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe e vendimit nr.11, të vitit 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. U konstatua se në 21 komisione në qendrat e votimit mungon ky dokument në kutinë e materialeve zgjedhore, në veprimin që bën me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e komisionit të qendrës së votimit. Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së komisionit të qendrës së votimit, i cili protokollon ankesat, kërkesat, njoftimet drejtuar KQV-së, regjistroq në librin e protokollit të mbledhjeve vendimet e KQV-së dhe ia përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara. Regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutitë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie. Në këto kushte, në mbështetje të fakteve të evidentuara nga procesi i kryqëzimit, rezulton sekretari i QV në këto 21 komisione të qendrës së votimit, nuk ka përmbushur këto kërkesa

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

ligjore. Në mesatarisht 82% të qendrave të votimit janë administruar raportet e identifikimit elektronik të nënshkruara edhe nga anëtarët e komisionit të votimit dhe vulosur nga sekretari. Janë administruar raportet e hapjes dhe të mbylljes së PEI-t në kutinë e votimit dhe në kutinë e materialeve zgjedhore. Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme, rezultoi se votat e pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

41% e votave të pavlefshme janë për shkak se është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;

25% e votave të pavlefshme janë për shkak se është votuar për një subjekt dhe për një kandidat të një subjekti tjetër;

15% e votave të pavlefshme janë për shkak se janë me shënime që po 00.12.18 vlerësimin e votës në favor, apo disfavor të subjekteve zgjedhore;

19% e votave të pavlefshme janë për arsye të tjera sipas përcaktimit të nenit 117, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Raporti rekomandon marrjen e masave organizative, sanksione administrative dhe bërjen e kallëzimeve penale për përmirësimet ligjore të mëtejshme. Referuar gjetjeve të verifikimit të pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik, të dhënat dhe informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes në procesverbale tip të miratuara me udhëzimin nr.15 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përmbajnë të dhëna sasiore dhe cilësore. Kategoria e parë e informacionit ka të bëjë me saktësinë e shifrave të rezultateve të procesit të vlerësimit të votës për kandidatët në subjektet dhe subjektet zgjedhore. Informacioni është përpunuar në sistem duke identifikuar vlerat për çdo kandidat dhe subjekt dhe diferencën për secilin prej tyre në nivel qendre votimi. Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave, midis votave fizike të gjetura në kuti dhe rezultate të sistemit të PEVN-së nuk u konstatua asnjë diferencë apo parregullsi. Në përfundim të procesit të këqyrjes, duke marrë në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021**

konsideratë mosgjetjen e asnjë parregullsie, sugjerojmë implementimin e sistemit PEVN në një shkallë më të gjerë në proceset e ardhme të votimit. Referuar udhëzimit nr.15, datë 07.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton raportet e propozuara nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe raportin e gjetjeve për fletët e votimit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Domethënë për një pjesë të shkeljeve të gjetura, kemi konkluduar që ato janë të karakterit administrativ dhe do t'i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve masë administrative. Për pjesën tjetër, ku në vlerësimin tonë shkeljet janë më të rënda se ato të natyrës administrative do të bëjmë kallëzim për ndjekje penale në organin e prokurorisë.

Atëherë në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja "e" dhe "n" dhe pika 2 dhe 23, dhe pika 8, si dhe neni 167/2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrjet paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor të 519 qendrave të votimit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore të të dhënave të pajisjeve të votimit elektronik dhe dokumentacionit zgjedhor të zonës së administrimit zgjedhor nr.40, Qarku Tiranë, sipas lidhjes 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. T'i kërkoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj sekretarëve të komisioneve të qendrave të votimit sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

4. Të bëj kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga anëtarët e grupeve të numërimit, sipas listës në lidhjen 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Vendimi nr. 470**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zonja Gjyste Gjon Kola, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kurbin, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.


Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kurbin me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G99, zonja Gjyste Gjon Kola.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 471**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

03.12.2021

Ora 11:29

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare, z. Nikolin Prend Luli”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2. Stafi KQZ:    **Y. Merkaj, M.Koja**

**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbin, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnje, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zoti Nikolin Prend Luli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mirditë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.


Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare, zotin Nikolin Prend Luli.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 472**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zonja Donika Vasil Kolagji, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Himarë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Himarë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Donika Vasil Kolagji.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 473**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

**03.12.2021**  
**Ora 11:32**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatën nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Kamela Ferdinant Banushi”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z. Ilirjan Celibashi**  
**2. Staf i KQZ:                                         Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**

***Z. I. Celibashi:*** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

***Z. Y. Merkaj:*** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbini, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnjë, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

***Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse.  
Faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zonja Kamela Ferdinand Banushi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Kamela Ferdinand Banushi. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 474**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

03.12.2021

Ora 11:32

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me  
kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Uniteti Kombëtar, z. Valentin Paulin  
Frani”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z. Ilirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:    Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbin, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnje, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zoti Valentin Paulin Frani, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.


Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Uniteti Kombëtar, zotin Valentin Paulin Frani.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 475**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



03.12.2021

Ora 11:33

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje, me kandidatën nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Ermal Harilla Rrushë”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**

**1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**

**2.Stafi KQZ:**      **Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbini, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnje, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:


Zoti Ermal Harilla Rrushi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lushnje, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lushnje me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Ermal Harilla Rrushi.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 476**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

03.12.2021  
Ora 11:34

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Divjakë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Klaudja Lulzim Turtulli”.**

**PJESËMARRJA :**


**KQZ**

- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z. Ilirjan Celibashi**  
**2. Stafi KQZ:**                                      **Y. Merkaj, M. Koja**  
**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Divjakë.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbin, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnje, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

ne parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zonja Klaudja Lulzim Turtulli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Divjakë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e këtij funksioni.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Divjakë me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Klaudiana Lulzim Turtulli.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 477**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

03.12.2021  
Ora 11:35

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz,  
me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Ndue  
Marash Doçi”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ**


1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**  
2. Staf i KQZ:                                      **Y. Merkaj, M. Koja**

**Parti Politike:**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë Këshilli i Bashkisë Kurbin, Këshilli i Bashkisë Mirditë, Këshilli i Bashkisë Himarë, Këshilli i Bashkisë Tiranë, Këshilli i Bashkisë Lezhë, Këshilli i Bashkisë Lushnjë, Këshilli i Bashkisë Divjakë dhe Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për shkak të dorëheqjes së këshilltarëve përkatës në këta këshilla bashkiakë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka informuar kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të cilët i kanë deklaruar dhe i kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i këtyre formularëve të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015: Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të gjithë kandidatët i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë përgjigjet përkatëse dhe konstatohet se të gjithë kandidatët e këtyre këshillave bashkiakë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të plotësojë vendet vakante me propozimet përkatëse. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 11, të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

Zoti Ndue Marash Doçi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fushë-Arrëz me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotin Ndue Marash Doçi.


Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këto ish-in lidhje me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

**Vendimi nr. 478**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

dhe Konservatorët, ABEOK, Qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, me numër unik: 993. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve fillimisht ka bërë verifikimin paraprak për të gjitha të dhënat të deklaruara nga ky subjekt vetëdeklarues dhe ka marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.138, të vitit 2015, ka verifikuar të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nga kandidati për deputet, zoti Daniel Gjin Prroji. Duke pasur parasysh shënimet e bëra në rubrikën 3, të formularëve të vetëdeklarimit, të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të personit, pyetjes 7, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “po”, pyetjes “a është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, ku ka deklaruar se në datën 20.06.2016 është dëbuar nga Luksemburg, për arsye të qëndrimit afatgjatë në këtë shtet. Gjithashtu pyetjes 8 të formularit të vetëdeklarimit “a keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me “po”, duke deklaruar se në vitin 2015, 2016, ka jetuar në Luksemburg për arsye pune. Duke analizuar përgjigjen e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe vetëdeklarimet e subjektit në formularin e vetëdeklarimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr.138, të vitit 2015, ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent për kryerjen e verifikimit të plotë të deklarimeve të bëra nga subjektet. Me vendimin nr.167, datë 18.03.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është miratuar lista shumemërore e Koalicionit ABEOK, sipas së cilës subjekti i verifikimit, zoti Daniel Prroj, nuk rezulton të jetë kandidat i kësaj liste shumemërore. Megjithatë procedura e verifikimit ka nisur mbi bazën e paraqitjes së listës paraprake nga ky subjekt

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

zgjedhor. Në datën 10.11.2021 nga Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, është dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Daniel Gjin Prroj. Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së të gjitha verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, i ka konsideruar këto verifikime të plota dhe bazuar në përcaktimin e nenit 8, dhe nenit 5, të ligjit nr.138, të vitit 2015, si dhe pikës 3, shkronja “ç”, të kreut 3, të pikave 10,11,12,13, të vendimit nr.17 të Kuvendit të Shqipërisë, ka miratuar rezultatin e verifikimit të subjektit vetëdeklarues Daniel Gjin Prroj. Për sa konstatohet pas paraqitjes së rezultatit të verifikimit nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, në zbatim të përcaktimit të nenit 10, të ligjit nr.138, të vitit 2015, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për vendimmarrjen, nëse konstaton, ose ekzistojnë ligjet e kushteve të ndalimit për të kandiduar sipas përcaktimit të këtij ligji. Zoti Daniel Gjin Prroj, pavarësisht regjistrimit paraprak të listës shumëmemërore të këtij subjekti zgjedhor, në bazë të vendimit nr.167, datë 18.03.2021, që ka miratuar listën shumëmemërore të koalicionit ABEOK, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, Qarku Shkodër. Për sa më sipër, zoti Daniel Gjin Prroj nuk ka marrë mandatin e deputetit, për këtë arsye Komisioneri nuk mund të shprehet, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e deputetit, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, nuk do të mund të marrë këtë funksion publik, për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, të moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit, për rastet e parashikuara në ligjin nr.138, të vitit 2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe në zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit të mësipërm, vlerësohet se ka humbur objektin dhe qëllimin e verifikimit të thelluar.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.12.2021*

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe relacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë sikurse në raste të tjera të ngjashme, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2 Kodi Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 90 dhe 95, të ligjit 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pika 12 dhe 13 të kreut të pestë, të vendimit nr.17 të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative, pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues, Daniel Gjin Proj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimin në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kjo ishte dhe pika e fundit e rendit të ditës.

Faleminderit, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 479**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

